

VENDIM
Nr.195, datë 19.2.2009

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “SHTIKË”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues, për kryerjen e procedurës ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim, transferim), të hidrocentralit “Shtikë”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Dhënie e bonusit prej 3 për qind të pikëve shoqërisë “Qeramika e Jugut”, sh.p.k., për rezultatin teknik e financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), për dhënie me koncesion të këtij hidrocentrali.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese përzgjedhëse, për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Shtikë”, të kërkojë shprehje të interesit dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha